



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
DURRËS

**ANALIZA VJETORE E PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË
PARË DURRËS**

I nderuar z. Prokuror i Përgjithshëm!

Para së gjithash dëshiroj t'ju falenderoj për angazhimin e treguar nga ana Juaj për të marrë pjesë në Analizën Vjetore të punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës parë Durrës, duke e konsideruar praninë tuaj mes nesh si shprehje të vlerësimit të punës së Prokurorisë Durrës dhe përpjekjeve të përbashkëta në luftën kundër krimit dhe shkeljeve të tjera të ligjit dhe në mënyrë të veçantë në hetimin dhe gjykimin e veprave penale në përputhje me kërkesat e ligjit procedural penal.

Më lejoni z. Prokuror i Përgjithshëm, të paraqes në mënyrë të përmbledhur treguesit e punës, progresin, përballjen me vështirësitë, zgjidhjet e dhëna dhe hapat e hedhura drejt zhvillimit dhe përmirësimit të standarteve dhe performancës së trupës së Prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së shkallës parë Durrës.

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, nëpërmjet analizës vjetore të saj, do të pasqyrojë në mënyrë të përgjithshme dhe të detajuar të gjithë treguesit lidhur me veprimtarinë e punës së saj për periudhën njëvjeçare. Ky informacion përmban të dhëna mbi treguesit e punës vjetore, numrin e çështjeve të mbartura nga viti i kaluar, numrin e çështjeve të regjistruara, mënyrën e zgjidhjes ligjore të tyre etj.

Nisur nga analiza e treguesve të veprimtarisë së Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, mund të themi se viti 2015 evidenton progres në rritje, në ushtrimin e përgjegjësiave kushtetuese e ligjore. Falë angazhimit të Prokurorëve në ushtrim të funksioneve dhe detyrave të tyre, në veprimtarinë e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës vihet re rritje e treguesve të volumit të punës, të efektivitetit dhe ligjshmërisë në ndjekjen penale, ngritjen e akuzës në gjykatë në emër të shtetit,

ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikqyrjen e vuajtjes së dënimit, si dhe në ushtrimin e funksioneve të tjera të ngarkuara me ligj.

Evidentohet progres krahasuar me vitet paraardhëse si dhe arritje në efektivitetin e ndjekjes penale kundër krimit për të cilat Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është kompetente për hetimin dhe ndjekjen e tyre. Pavarësisht nga të dhënat që do të prezantohen, jemi të vetëdijshëm se duhet të merren masa të tjera të domosdoshme për të garantuar rritjen e suksesit në luftën kundër krimit, duke kërkuar mbështetje dhe në strukturat e tjera ligjzbatuese të shtetit.

Mënyra më sintetike e përshkrimit të punës së Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës në ushtrimin e funksioneve të saj është gjuha e shifrave, prandaj më lejoni t'ju paraqes të grupuara treguesit e punës për periudhën një-vjecare, shtrirjen dhe tendencat e kriminalitetit.

PËRMBAJTJA

I. Prezantimi i Prioriteteve dhe arritjeve të Prokurorisë Pranë Gjykatës Shkallës së Parë Durrës për vitin 2015.....	4
1.Prioritetet për vitin 2015.....	4
2.Raportet me institucionet e tjera.....	6
II. Treguesit kryesorë të procedimeve penale në fazën e hetimeve paraprake dhe ngritjen e akuzës në gjykatë.....	7
1.Volumi i punës	7
2.Mosfillimet	10
3.Ngarkesa e punës së prokurorëve gjatë vitit 2015	11
III. Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale	13
IV. Treguesit kryesorë të përfaqësimit të akuzës dhe të politikës së dënimit në gjykim.	13
V. Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë dhe të mbikqyrjes së vuajtjes së dënimit.....	20
VI. Treguesit kryesorë mbi llojet, format, intensitetin, gjendjen dhe shtrirjen e veprave penale.....	22
VII. Përmbushja e angazhimeve dhe detyrave të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për vitin 2016.....	51

I. PREZANTIMI I PRIORITETEVE DHE ARRITJEVE TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SHKALLËS SË PARË DURRËS PËR VITIN 2015

1. PRIORITETET PËR VITIN 2015

Në tërësinë e veprave penale të regjistruara gjatë vitit 2015 organi i prokurorisë është fokusuar në mënyrë të veçantë në disa çështje specifike për të cilat prokurorët kanë qenë të përqendruar në hetimin e tyre dhe kryesisht në hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit, krimit kibernetik, si dhe veprave penale të kryera nga punonjësit shtetërorë kundër veprimtarisë shtetërore, lidhur me hetimin e këtyre veprave penale ekziston një frymë pozitive dhe bashkëpunuese në rritje ndërmjet institucioneve.

Vlen të theksohet që bashkëpunimi ndërmjet institucioneve për hetimin e këtyre veprave penale duhet të forcohet dhe më tej pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihen rezultate të dukshme në luftën kundër autorëve të këtyre veprave penale.

Rol kryesor në hetimin e këtyre veprave penale ka Njësia e Përbashkët Hetimore e cila gjatë këtij viti ka vazhduar përpjekjet e saj për të forcuar dhe konsoliduar më tej bashkëpunimin me strukturat e specializuara në ushtrimin e ndjekjes penale, në fushën e korrupsionit, krimit ekonomik, pastrimit të parave dhe krimit kibernetik.


Me gjithë vlersimin e mirë që duhet bërë për prokurorët e Njesisë së Përbashkët Hetimore, në kuadrin e hetimit të këtyre veprave penale, vlen për tu theksuar fakti për punën e dobët të tyre në hetimin e veprës penale të "Pastrimit të Produkteve të Veprës Penale" parashikuar nga neni 278 i K.Penal.

Si rezultat i punës së dobët të Prokurorëve ,Of.Pol.Gjyqësore dhe kordinimit me strukturat e tjera të zbatimit të ligjit dhe për vitin 2015 nuk është arritur të përmirësohet puna dhe treguesit e ndjekjes penale për këtë vepër.

Nga të dhënat statistikore rezulton se për vitin 2015 janë regjistruar 24 procedime për këtë vepër penale dhe asnjë procedim penal nuk është dërguar për gjykim. Po ashtu punë e dobët e Njesisë së Përbashkët Hetimore konstatohet dhe në hetimet proaktive.

Tabela e mëposhtme tregon ngarkesën e punës së prokurorëve të Njesisë së Përbashkët Hetimore për çështjet penale të hetuara, gjykuara, pushuara, mosfilluara, pezulluara, etj.

Prokurorët	Referim	Kryesisht	Mosfilluar	Verifikim i kallzimeve në ndjekje	Mbartur procedime nga 2014	Rifillime	Procedime të reja	Totali i procedimeve në Hetim	Pushim	Pezullim	Transferim	Gjykim	Totali përfunduar Hetimet	Mbartur në Hetim për periudhën në vazhdim	Mbartur ne Gjykim nga 2014	Gjithsej në Gjykim proc	Përfunduar Gjykimi gjithsej procedime	Fajësi	Pafajësi ose Pushim Gjykimi	Mbartur në gjykim për periudhën në vazhdim
A.Shehu	72	2	34	5	48	22	74	144	38	12	4	35	89	45	50	93	65	60	5	28
D.Gina	10	-	6	2	53	4	10	67	23	10	2	15	50	10	13	29	9	22	1	7
E.Pelushi	39	1	27	-	57	28	40	125	23	22	4	23	72	43	5	24	15	20	-	4
G.Veizi	40	-	35	-	50	26	40	116	26	19	3	30	78	18	7	24	7	14	1	10
R.Halili	12	0	1	9	3	1	8	12	0	0	0	1	1	10	0	0	1	1	0	0
Totali	173	3	103	16	211	81	172	464	110	63	13	104	290	126	75	170	97	117	7	49



Prioritet tjetër i rëndësishëm në punën tonë ka qenë dhe ngelet respektimi i të drejtave të të miturit dhe personave të arrestuar apo ndaluar, në këtë drejtim nga ana e trupës së prokurorëve janë zbatuar me përpikmëri Udhëzimet dhe Urdhërat e Prokurorit të Përgjithshëm lidhur me të drejtat e shtetasve të mitur, të cilët kanë rezultuar të përfshirë në kryerjen e veprave penale, duke siguruar pjesëmarrjen e psikologut në hetimin e procedimeve penale ku rezulton të jenë përfshirë të miturit, duke ruajtur fshehtësinë e informacionit si dhe duke aplikuar dënime alternative. Po ashtu nga trupa e prokurorëve janë respektuar dhe ndjekur me përparësi të drejtat e shtetasve të ndaluar apo arrestuar si në fazën e hetimeve paraprake ashtu dhe gjatë gjykimit të procedimit penal në ngarkim të tyre.

Krahas prioriteteve në hetimin e veprave penale që hetohen nga Prokurorët e Njesisë së Përbashkët Hetimore, trupa e Prokurorëve është përqëndruar duke i kushtuar vëmendje dhe kujdes dhe hetimit të veprave penale të rëndësishme siç janë, Krimet Kundër Jetës të Kryera me Dashje, Krimeve në Familje, Veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, Ndërtimi i paligjshëm, Drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur apo pa dëshmi aftësie, Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit si dhe Vjedhja e Pasurisë etj. Keto vepra penale zënë dhe peshën me të madhe të hetimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

2. RAPORTET ME INSTITUCIONET E TJERA

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, gjatë vitit 2015 ka patur dhe mbartur marrëdhënie korrekte dhe pozitive me institucionet e tjera, të cilat janë të përfshira dhe të lidhura me punën tonë. Në këto marrëdhënie rolin kryesor e zënë ato që lidhen me:

**Prokurorinë e Përgjithshme
Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës,
Prokurorinë e Apelit Durrës
Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës
Institucione të tjera në nivel lokal**

-Në raport me Prokurorinë e Përgjithshme, gjatë vitit 2015 është vërejtur një raport shumë i ngushtë bashkëpunimi i cili kosiston në gadishmërinë e plotë për bashkëpunim dhe ndihmë nga të gjitha drejtoritë pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

-Raportet me Gjykatën e rrethit Gjyqësor Durrës, gjatë vitit 2015 kanë qenë korrekte dhe ligjore duke u bazuar në korrektesën e ndërsjelltë dhe reciproke. Vlerësojmë impenjimin e trupës gjyqësore (dhoma penale) për trajtimin e problematikave të veçanta të evidentuara për disa çështje.

-Raporti me Prokurorinë e Apelit Durrës, vazhdojnë të jenë raporte reciproke dhe të ndërsjellta duke mbajtur kontakte të vazhdueshme në funksion të përfaqësimit të akuzës lidhur me çështjet penale të ankimuara nga Prokurorët pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës. Pavarësisht marrëdhënieve korrekte që kemi me Prokurorinë e Apelit Durrës vlen për tu theksuar fakti që në disa raste nga prokurorët e Apelit nuk është bërë përkrahja e ankimit të ushtruar nga Prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, raste të cilat janë përfaqësuar nga vetë prokurorët që kanë ushtruar ankimin ndaj vendimit të Gjykatës. Ku në disa raste gjykata e Apelit ka vendosur sipas kërkesës së Prokurorit i cili ka ushtruar ankimin.

-Raporti me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës, vazhdon të jetë një raport bashkëpunimi ndërinstytucional në angazhim të përbashkët për hetimin e krimit, duke patur në fokus të këtij bashkëpunimi Urdhërat dhe Udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm. Pavarësisht marrëdhënieve të mira bashkëpunuese konstatohet se ka zvarritje të afateve të hetimit të procedimeve penale nga ana e Of.Pol.Gjyqësore të ngarkuar me hetimin dhe shkak kryesor i këtyre zvarritjeve rezulton të jetë transferimi i Oficerëve të Policisë Gjyqësore në kohë të shkurtra dhe në këtë drejtim nuk është mbajtur parasysh Urdhëri i Përbashkët i Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm për Policinë Gjyqësore.

-Raporti me institucionet e tjera vazhdon të jetë një raport korrekt, institucional dhe i ndërsjelltë me Organet e Qeverisjes Vendore etj.

II. TREGUESIT KRYESORË TË PROCEDIMEVE PENALE NË FAZËN E HETIMEVE PARAPRAKE DHE NGRITJEN E AKUZËS NË GJYKATË.


1. VOLUMI I PUNËS

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, gjatë vitit 2015 në hetimet paraprake ka ndjekur **3254** procedime penale, me **1404** të pandehur, nga të cilët **503** persona me masë sigurimi "Arrest në burg". Nga këto, janë regjistruar **2381** procedime penale të reja, me **1060** të pandehur, prej të cilëve **493** persona me masë sigurimi "Arrest në burg". Është vendosur mosfillim për 1536 referime dhe kallzime penale, referuar vitit 2014 kemi një rritje prej 19.53%.

Krahasuar me vitin 2014 numri i procedimeve penale të regjistruara është ulur në masën **3,87%**.

Më poshtë, në tabelë paraqitja krahasuese e viteve 2014-2015 evidenton treguesit e procedimeve penale të ndjekura, përfshi dhe procedimet penale të mbartura nga viti 2014, të regjistruara dhe të rifilluara në vitin 2015.

Vitet	Proc.Mbartura	Proc.Rregjistruara	Proc.Rifilluara	Proc.Ndjekje Penale
2014	774	2477	68	3239
2015	451	2381	105	3254
Krahasimi	Ulur 41,73%	Ulur 3,87%	Rritur 54,41%	Rritur 0.46%




Evidentohet tendenca në ulje e numrit të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2014.

Në vitin 2015 janë përfunduar hetimet për **2803** procedime penale, me **1708** të pandehur, që zënë **86,14%** të procedimeve penale të ndjekura ose **13,57%** procedime penale të përfunduara më shumë se viti 2014.

Më poshtë tabela evidenton treguesit e procedimeve penale dhe të pandehurve sipas mënyrës së përfundimit të ndjekjes penale në hetimet paraprake, krahasuar me vitet 2014-2015.

Vitet	Gjyqit		Pushuara		Pezulluara		Përfunduara	
	Procedi me	Pande hur	Procedi me	Pande hur	Procedi me	Pande hur	Procedi me	Pande hur
2014	1001	1052	360	220	950	0	2468	1276
2015	1276	1408	474	277	1002	1	2803	1708
Krahasimi	Rritur 27,47%	Rritur 33,84%	Rritur 31,66%	Rritur 25,9%	Rritur 5,47%	Rritur 100 %	Rritur 13,57 %	Rritur 33,85%



Sipas mënyrës së përfundimit të hetimeve në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës rezulton kjo gjendje:

1.1 Është ngritur akuzë në gjykatë për **1276** procedime penale, me **1408** të pandehur prej të cilëve **493** persona me masë sigurimi "Arrest në Burg". Kraheluar me vitin 2014 kemi një rritje prej 27,47% të procedimeve dhe 33,84% të pandehurve. Në ndjekjen penale në hetim evidentohen se janë dërguar në gjykatë 45,52% e procedimeve të përfunduara ose është ngritur akuzë për 82,43% të të pandehurve ndaj të cilëve janë përfunduar hetimet.

1.2 Janë pushuar **474** procedime penale me **277** të persona "ndaj të cilit", me **6** persona me masë sigurimi "Arrest në burg" që zënë 27,75% të procedimeve penale të përfunduara.

Kraheluar me vitin 2014 kemi një rritje prej 31,66% të procedimeve penale të pushuara, si dhe rritje me 20% të pushimeve me persona me masë sigurimi "Arrest në burg". Fenomeni i vendimeve të pushimit të çështjes penale në kushtet kur personat e hetuar janë me masë sigurimi "Arrest në burg" pavarësisht se numri i të pandehurve në krahasim me totalin e çështjeve të pushuara është i vogël, duhet të konsiderohet shqetësues. Si rezultat i punës së përbashkët të prokurorisë me strukturat e policisë

gjyqësore të Policisë së Komisarariatit Durrës janë rifilluar hetimet për **24** procedime të pezulluara, si rezultat i zbulimit të autorit apo të dhënave të tjera të cilat ndihmojnë në zgjidhjen e çështjeve. Po ashtu rezulton se për vitin 2015 Prokurorët kanë ndërmarrë pushimin për **652** procedime penale për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

Për të minimizuar këto raste është tërhequr vëmendja e të gjithë trupës së prokurorëve të Prokurorisë Durrës në mënyrë të vazhdueshme që të bëjnë kujdesin maksimal kur të operojnë me vendosjen e masave të sigurimit personal ndaj shtetasve veçanërisht me masën e sigurimit “Arrest në burg”, në mënyrë që kërkesa për vendosjen e kësaj mase të mos çënojë padrejtësisht liritë e shtetasve dhe të mos shndërrohet në një mjet shantazhimi ndaj tyre. Sipas shkaqeve ligjore mbi të cilët është vendosur pushimi i çështjeve evidentohet se:

1.3 Pezullimi i hetimeve është vendosur për **1002** procedime penale, që zënë 35,74 % të procedimeve penale të përfunduara dhe krahasuar me vitin 2014 kemi një rritje 5,47 %. Të ndarë sipas shkaqeve ligjore për të cilët është vendosur pezullimi gjendja paraqitet;

- Për shkak se autori i veprës penale nuk njihet janë pezulluar hetimet dhe vazhdon gjurmimi nga policia për zbulimin e autorëve për **1001** procedime penale që zënë 99.9% të çështjeve të pezulluara.
- Ndërsa, për shkak se të pandehurit kanë vuajtur nga një sëmundje e rëndë kemi pezulluar vetëm **një** procedim penal.

1.4 Me zgjatje afati janë ndjekur **295** procedime, që zënë rreth 10.52 % të procedimeve penale të hetuara, krahasuar kjo me një vit më parë kemi një rritje prej 23,94%.

1.5 Janë **mbartur** për vitin 2016 në fazën e hetimeve paraprake **451** Procedime Penale, me **154** të pandehur, prej të cilëve **91** persona me masë sigurimi “Arrest në burg”, pra rreth 16,08 % e numrit të përgjithshëm të procedimeve penale të hetuara gjatë vitit 2015, krahasuar me vitin 2014 janë mbartur 41,73% procedime më pak.

2. MOSFILLIMET

Organi i prokurorisë është organi kompetent që bën regjistrimin e njoftimit/kallëzimit të veprave penale të cilat mund të vijnë nga subjekte e në rrugë të ndryshme.

Kjo nuk do të thotë se në çdo kallëzim të bërë nga subjektet e parashikuara nga nenet 281 dhe vijues të Kodit të Procedurës Penale ekzistojnë elementet e veprës penale. Me qellim që të evitohen hetimet e panevojshme, ligjvënësi në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar edhe të drejtën e prokurorit që në mungesë të ekzistencës së rrethanave për fillimin e procedimit, të japë vendimin e arsyetuar për mosfillimin e procedimit.

Ky tregues i punës ka pësuar rritje këtë vit në krahasim me vitin e kaluar, pasi rezultoi se për vitin 2014 nga **1431** referime është vendosur mosfillim për **1285** materiale, ndërsa në vitin 2015 nga **1621** referime është marrë vendimi për mosfillimin e procedimit për **1536** kallezime apo referime të veprës penale në Prokurori për “Rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit”, nenet 290 e 291 të K.Pr.Penale.

Krahasuar me vitin 2014 kemi një rritje me **19,53** %. Në rritjen e procedimeve të mosfilluara kanë ndikuar dhe materialet referuese të ardhura nga shërbimet e policisë gjyqësore me sugjerimin për vlerësim nga ana e Prokurorit.

Në lidhje me çështjet e përfunduara nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykata e Apelit janë prishur 15 vendime të Prokurorëve.


3. NGARKESA E PUNËS SË PROKURORËVE GJATË VITIT 2015

Gjatë vitit 2015, nga ana e Prokurorëve të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është përballuar një ngarkesë pune e konsiderueshme e çështjeve penale dhe gjykimeve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Ashtu siç edhe e kemi trajtuar në pikën e parë të këtij raporti (Analize), rezultoi se nga prokurorët është hetuar dhe përfunduar një numër më i madh çështjesh penale, se ato të regjistruara gjatë gjithë vitit 2014.

Më konkretisht po japim në një tabelë përmbledhëse të dhënat e ngarkesës së secilit prokuror dhe mënyrën e përfundimit të çështjeve prej tyre.

Nr.	Prokurori	Totali	Mosfilluar	Pushuar	Gjykatës	Pezulluar	Transferuar	Në hetim
1	K.Bashaj	248	123	25	124	67	6	26
2	D.Pali	226	122	21	97	74	4	30
3	E.Xhengo	225	108	27	111	61	1	25
4	N.Troplini	224	115	26	85	83	5	25
5	V.Mara	223	102	26	88	81	3	25
6	B.Bejko	214	116	34	89	57	3	31
7	T.Rrudha	208	96	24	72	77	3	32
8	F.Reka	184	72	22	84	57	2	19
9	D.Prela	180	100	30	66	61	5	18
10	A.Sharra	175	85	16	73	59	3	24
11	R.Halili	169	78	31	62	64	2	10

12	A.Ndoja	147	54	17	64	50	2	14
13	A.Felaj	124	46	17	54	36	0	17
14	A.Shehu	123	39	44	24	11	1	43
15	A.Bebeci	114	66	10	42	34	1	27
16	E.Pelushi	110	27	24	23	20	1	42
17	G.Veizi	104	35	35	31	18	3	17
18	O.Gjoni	59	30	7	18	24	0	10
19	D.Gina	56	8	22	13	9	1	11
20	I.Turja	42	91	8	19	14	1	0
21	A.Jella	41	20	5	14	20	2	0
22	E.Koloshi	23	14	5	9	7	2	0
23	Q.Kadija	16	15	2	5	9	0	0
24	S.Nishani	11	46	1	3	6	0	1
25	P.Decolli	7	13	1	4	2	0	0
26	S.Bahiti	1	0	0	1	0	0	0



III. TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE

Bazuar në të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 janë **filluar kryesisht 6** procedime penale nga ana e prokurorisë prane gjykates se shkalles se pare Durres.

Kallëzime nga nëpunësit publikë: Ne vitin 2015 rezulton të jenë 98 kallëzime, që do të thotë ulje prej 19.67% në krahasim me vitin 2014.

Kallëzime nga shtetasit: Ne vitin 2015 rezultojnë 81 kallëzime të bëra nga shtetasit që do të thotë ulje prej 67.2% në krahasim me vitin 2014.

Gjatë vitit 2015 është marrë njoftim për **14 ngjarje**, që do të thotë ulje 6.66 % në krahasim me vitin 2014.

Gjithashtu, theksojmë se, gjatë vitit 2015 janë marrë **2178 referime nga Policia e Shtetit**, që do të thotë rritje prej 7.92 % në krahasim me vitin 2014.

Gjatë vitit 2015 nuk janë bërë **kallëzime nga CEZ**, që do të thotë kemi një ulje prej 100 % në krahasim me vitin 2014.

IV. TREGUESIT KRYESORË TË PËRFAQËSIMIT TË AKUZËS DHE TË POLITIKËS SË DËNIMIT NË GJYKIM.

Një pjesë të konsiderueshme të ngarkeses së punës së secilit prokuror zë edhe pjesmarrja në gjykim, të cilën e kemi analizuar si një tregues të veçantë të punës së secilit prokuror. Vihet re, një tregues në rritje i cilësisë në ushtrimin e ndjekjes penale, si dhe një numër i lartë i dërgimit të çështjeve në gjykim. Kështu rezulton se gjatë këtij viti prokurorët kanë përfunduar gjykimin e këtyre çështjeve penale.

Nr.	Prokurori	Pasqyra e çështjeve të gjykuara
1	Kujtim Bashaj	121
2	Enkeleda Xhengo	94
3	Drini Pali	92
4	Vladimir Mara	88
5	Bledar Bejko	80
6	Ndricim Troplini	72
7	Donika Prela	67
8	Arben Sharra	61
9	Alma Felaj	60

10	Flora Reka	58
11	Rabiana Halili	56
12	Arian Ndoja	40
13	Anila Bebeci	33
14	Afrim Shehu	27
15	Gezim Veizi	27
16	Teuta Rrudha	25
17	Dritan Gina	24
18	Ilir Turja	17
19	Elena Pelushi	12
20	Anita Jella	9
21	Oltiana Gjoni	5
22	Qydret Kadija	4
23	Sokol Nishani	3
24	Edmond Koloshi	3




Gjatë vitit 2015, prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës kanë përfaqësuar akuzën në gjykimet penale të **1276** çështjeve, në ngarkim të **1425** të pandehurve, prej të cilëve **493** persona me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Nga Procedimet Penale të dërguara për gjykim, këtë vit janë përfunduar **1078** procedime penale me **1306** të pandehur, prej të cilëve **385** të arrestuar.

Krahasuar me një vit më parë kemi një numër pothuaj të njëjtë të procedimeve penale dhe një rritje prej 2,59% të të pandehurve ndaj të cilëve është përfaqësuar akuza në gjykatë, sipas tabelës si më poshtë:

Vitet	Gjykuar		
	Procedime	Pandehur	Arrestuar
2014	1072	1273	462
2015	1078	1306	493
Krahasimi	Rritur 0,5%	Rritur 2,59%	Rritur 6,7%



Analiza e treguesve sipas llojeve të gjykimit të ekspozuara në tabelën e mëposhtme evidenton se:


Për **73,65%** të çështjeve të gjykuara është aplikuar gjykimi i shkurtuar ose 37,03 % më pak se në vitin 2014.

Për **6,86 %** të çështjeve të gjykuara është aplikuar gjykimi i zakonshëm, krahasuar me vitin 2014 kemi një rritje të gjykimeve të zakonshme me 37.03%

Për **18,73 %** të çështjeve është aplikuar gjykimi i drejtëpërdrejtë, krahasuar me vitin 2014 kemi një rritje të gjykimit të drejtëpërdrejtë në 15.2%

Për **0,74 %** është aplikuar gjykimi në mungesë, krahasuar me vitin 2014 kemi rritje të këtij lloji gjykimi.

Vitet	Llojet e Gjykimit			
	Drejtëpërdrejtë	Zakonshëm	Shkurtuar	Në Mungesë
2014	175	54	840	3
2015	202	74	794	8
Krahasimi	Rritur 15,2%	Rritur 37,03 %	Ulur 5,47%	Rritur 166,6%




Në gjykimin e këtyre çështjeve prokurorët kanë kërkuar krahas deklarimit fajtor, dënimin e të pandehurve me lloje dënimi si; **244** persona me gjobë dhe **1031** persona me burgim. Kërkesat për dënimin me burgim zënë 47.67% të kërkesave të prokurorëve dhe sipas llojeve të dënimit ato paraqiten: 4 me dënim në minimum, 1006 me dënim mesatar, 1 me dënim maksimal dhe 296 me pezullim të ekzekutimit të dënimit me

burgim. Gjithashtu këtë vit prokurorët kanë kërkuar tërheqjen e akteve për 4 procedime penale, pushimin e akuzës dhe pushimin e çështjes në gjykim për 21 të pandehur, ku për 1 të pandehur është kërkuar pushimi për “Amnisti”.


Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, mbi këto kërkesa ka vendosur deklarinimin fajtor për 1229 të pandehur.

Kërkesa e prokurëve dhe vendimet e gjykatës për llojin dhe masën e dënimit paraqitet sipas tabelës.

	2014		2015		Krahasimi	
Lloji i kërkesës	Kërkesa Prokurorit	Vendime Gjykatës	Kërkesa Prokurorit	Vendime Gjykatës	Kërkesa Prokurorit	Vendime Gjykatës
Gjobë	120	114	243	242	Rritur 102.5 %	Rritur 112.28 %
Burgim	607	423	1036	978	Rritur 70.84 %	Rritur 131.44%
Neni 59	222	269	296	342	Rritur 33.33%	Rritur 27.13%
T/Akteve	--	--	4	3	Rritur 100%	Rritur 100%
Pushuar	14	14	21	19	Rritur 50 %	Rritur 42,85 %
Pafajësi	--	29	1	33	Rritur 100%	Rritur 13,79%
Përjashtim nga dënimi	--	--	2	2	Rritur 100%	Rritur 100%



	2014		2015		Krahasimi	
Lloje dënimi me burgim	Kërkesa Prokurorit	Vendime Gjykatës	Kërkesa Prokurorit	Vendime Gjykatës	Kërkesa Prokurorit	Vendime Gjykatës
Minimum	6	9	4	5	Ulur 33.33 %	Ulur 44.44 %
Mesatar	600	528	1006	959	Rritur 67.66 %	Rritur 81.62 %
Maksimum	1	--	1	1	Njesoj	Rritur 100 %
Pezullim ekzekutimi	222	269	296	342	Rritur 33.33 %	Rritur 27.13 %



Rritja e efektivitetit të ndjekjes penale dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të individit nga Prokurorët në ushtrimin e funksioneve të tyre mbetet një ndër synimet tona kryesore. Në analizë të këtyre treguesve, krahas arritjeve në rritjen e efektivitetit të ndjekjes penale jemi fokusuar gjithnjë e më shumë në përmirësimin e punës tonë në ushtrimin e funksioneve si më poshtë:

Së pari, prokurorët janë udhëzuar që të përdorin më gjerësisht teknikat e veçanta të hetimit në kërkimin dhe administrimin e provave siç janë përgjimet, vëzhgimet, agentin e infiltruar dhe ekzaminime të tjera shkencore të provave objektive, veçanërisht për krime të rënda që janë në kompetencë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë.

Së dyti, për të zgjedhur dhe kërkuar në gjykatë masa sa më të përshtatshme të sigurimit personal, duke patur si synim që masa e sigurimit “arrest në burg” të aplikohet vetëm për krime të rënda dhe në ato raste kur masa alternative nuk është e përshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veprës penale dhe të pandehurit.

Së treti, në zbatim të urdhrave të Prokurorit të Përgjithshëm, janë bërë përpjekje për të forcuar më tej kujdesin në ngritjen e akuzës dhe përfaqësimin e saj në gjykatë, me synim për të shmangur çdo procedim në kundërshtim me ligjin apo kërkesë për dënim të padrejtë, në këtë kuadër kemi rritje të rasteve që gjykata ka kthyer aktet ose të ketë vendosur pafajësi, konkretisht janë dhënë 29 pafajësi gjatë vitit 2014 dhe 33 pafajësi gjatë vitit 2015, pra kemi një rritje me 13.79%. Vërehet rritje edhe në numrin e pushimit të çështjeve me 42,85 %.

Së katërti, jemi munduar dhe kemi patur gjithmonë në vëmendjen tonë shmangien e ashpërsimit të panevojshëm të kërkesave për lloje dhe masa dënimi, duke përshtatur më mirë kërkesat për dënime në përputhje me një politikë penale sa me të drejtë, me synim aplikimin e dënimeve alternative për kundravajtjet penale dhe veprat penale me rrezikshmëri të vogël shoqërore.

Së pesti, jemi orientuar drejt qëndrimeve të unifikuara në kërkesat për llojin dhe masën e dënimit, veçanërisht për vepra penale të kryera më shpesh në rrethin e Durrësit, me qëllim për të shmangur shkeljen e barazisë para ligjit si dhe shmangien e rasteve kur kërkesa e prokurorit për të njëjtën vepër penale të kërkojë masa dënimi të ndryshme. Njëjtësimi në dhënien e dënimit i shërben rritjes së efektivitetit dhe racionalizimit të procesit të punës së prokurorit.

V. TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË DHE TË MBIKQYRJES SË VUAJTJES SË DËNIMIT.

Funksion i organit të prokurorisë është edhe ekzekutimi i vendimeve penale. Për të gjitha vendimet gjyqësore të formës së prerë të marra gjatë vitit 2015, organi i prokurorisë ka urdhëruar ekzekutimin e tyre. Më konkretisht gjatë vitit 2015, prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës kanë urdhëruar ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë për 672 të dënuar me burgim dhe për 234 me dënim më gjorbë. Nga këto janë ekzekutuar nga policia gjyqësore dhe përmbarimi 659 vendime penale të evidentuar në tabelën e mëposhtme:

Llojet e dënimit	Urdhëruar ekzekutimi	Ekzekutuar	Të mbartura nga vitet e tjera pa u ekzekutuar	Të mbartura nga viti 2015 pa u ekzekutuar	Ngelen për tu ekzekutuar
Burg	672	632	382	40	422
Gjorbë	234	27	374	207	581
Dënim plotësues	22	11	32	11	43
Denime alternative	515	116	667	399	1066
Gjithsej 2015	1443	786	1455	657	2112

Së bashku me vendimet e mbartura nga vitet e kaluara ngelen për tu ekzekutuar dhe 2112 vendime gjyqësore të formës së prerë, nga të cilat 422 me burgim (persona ne kërkim) dhe 36 dënime me gjobë.

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës i ka kushtuar një vëmendje problemit të ekzekutimit të vendimeve penale gjyqësore të formës së prerë, duke zbatuar dispozitat dhe kërkesat ligjore të K.Pr.Penale dhe ligjit nr.8331 datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale". Në të gjitha rastet prokurori i ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë ka nxjerrë urdhrat e ekzekutimit pasi i janë vënë në dispozicion vendimet penale të formës së prerë nga gjykata, por ka raste dhe kur këto vendime janë tërhequr kryesisht nga prokurori. Urdhrrat e ekzekutimit janë nxjerrë brenda afateve ligjore dhe u janë dërguar për zbatim organeve të Policisë për masat sigurimit, I.E.V.Penale për dënimet me burgim dhe Zyrës Përmbartimore për dënimet me gjobë.

Krahas ekzekutimit të vendimeve penale të gjykatës prokurorët kanë marrë pjesë në gjykimin e kërkesave të veçanta të të dënuareve, për aplikimin e lirimit me kusht, qëndrim në shtëpi dhe lirimit për shkak sëmundje. Gjatë vitit 2015 janë shqyrtuar gjithsej 59 kërkesa, kryesisht nga të dënuarit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës, prej të cilave 5 të mbartura nga viti 2014. Kërkesat e të dënuareve kanë qenë: 44 kërkesa për aplikimin e nenit 64 të K.Penal, 11 kërkesa për aplikimin e nenit 59/a të K.Penal dhe 4 kërkesa për nenin 478 të K.Pr.Penale.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesave të mësipërme Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur për 36 prej tyre pushim gjykimi pasi vetë kërkuesi ka hequr dorë, për 11 kërkesa ka shpallur moskompetencën, për 12 kërkesa është vendosur pranimi tyre. Për këto kërkesa të pranuar për 6 ka kërkuar prokurori, ndërsa për 12 kërkesa të pranuar prokurori ka kërkuar rrëzimin e tyre. Gjithashtu gjykata ka vendosur rrëzimin për 36 kërkesa, për të cilat edhe prokurori ka kërkuar rrëzimin e tyre.

Në periudhën analizuese janë përfunduar 59 kërkesa dhe 2 kërkesa janë mbartur për vitin 2016.

Për rritjen e efektivitetit të punës lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale është forcuar bashkëpunimi me organet e policisë, veçanërisht për personat e dënuar të shpallur në kërkim, ku çdo muaj analizohet ky problem duke rakorduar dhe pasqyruar në vazhdimësi ndryshimet e listës së personave në kërkim. Megjithë përmirësimet e bëra dhe të evidentuara përsëri vazhdon që të ketë vendime gjyqësore penale të formës së prerë të paekzekutuara.

Mbikqyrja e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në veçanti për vënien në ekzekutim të dënimeve me burgim si dhe respektimi i të drejtave të të dënuarve gjatë vuajtjes së dënimit me burgim mbetet një ndër drejtimitet e punës tonë me synim riedukimin, rehabilitimin dhe ri-integrimin e të dënuarve në shoqëri, duke bashkëpunuar dhe bashkërenduar punën tonë me atë të Z.V.Sh.Provës. Në këtë drejtim mendoj se duhet të punohet për arritjen e një politike dënimi e cila duke marrë parasysh

gjëndjen e kriminalitetit në rrethin e Durrësit dhe specifikat psiko-sociale të shoqërisë, të mbështetet në parimin që nëpërmjet dënimeve gjyqësore të arrihet goditja e krimit dhe jo e shoqërisë.

Rezultatet e sipërpërmendura në treguesit kryesorë të aktivitetit të organit të Prokurorisë Durrës janë rrjedhojë e rritjes së përgjegjësisë për realizimin e detyrave nga ana e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, është forcimi i disziplines në punë dhe i kërkesës së vazhdueshme për realizimin e objektivave dhe veprimeve procedurialo-penale. Në këtë drejtim analizat e vazhdueshme dhe ato herë pas here me Prokurorët dhe oficerët e shërbimeve të policisë gjyqësore kanë rritur shpejtësinë në hetimet paraprake dhe u janë dhënë zgjidhje ligjore si kallëzimeve ashtu dhe procedimeve penale në hetim. Kjo ka bërë që muajt e fundit shumë pak procedime penale të hetohen me zgjatje afati, që besimi i qytetarëve tek organi i Prokurorisë të ketë ardhur në rritje, ndërsa ankesat dhe kërkesat e subjekteve të tjerë të procedimeve penale të jenë pothuajse në shifra të papërfillshme.

VI. TREGUESIT KRYESORË MBI LLOJET, FORMAT, INTENSITETIN, GJENDJEN DHE SHTRIRJEN E VEPRAVE PENALE.

Në tërësinë e veprave penale të regjistruara gjatë vitit 2015 organi i prokurorisë është fokusuar në mënyrë të veçantë në disa çështje specifike për të cilat trupa e prokuroreve kanë qenë të përqëndruar në hetimin e tyre, të cilët janë:

KRIME KUNDER JETËS TË KRYERA ME DASHJE

“Krime kundër jetës të kryera me dashje” përbën një nga grupet e veprave penale që kërkojnë vemëndje maksimale, pasi lidhen drejtpërdrejtë me sigurinë e jetës dhe shëndetit të qytetareve. Nga të dhënat statistikore, rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 50% të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë grup veprash në krahasim me vitin 2014.

Gjithsesi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, duhet theksuar se gjatë vitit 2015, në krahasim me vitin 2014, ka një ulje të procedimeve penale në veprën penale me të rëndësishme, të përfshirë në këtë grup, e cila është “vrasje në rrethana cilësuese”, ku konstatohet një ulje në masën 25 % krahasuar me një vit më parë.

Ndërkohë, vërehet një rritje me 22,22 % të procedimeve penale për veprën “vrasje me paramendim”.

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2015 është 1,25 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa për vitin 2014 ky grup veprash përbënte 0,8 % të totalit të procedimeve. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun “Krime kundër jetës të kryera me dashje”.

KRIME KUNDËR JETËS TË KRYERA ME DASHJE	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 76 Vrasja	4	3	5	3	5	7	2	8	2	1
Neni 78 Vrasja me paramendim	9	2	1	2	1	11	1	2	1	2
Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese	4	4	6	5	1	3	1	2	1	1
Neni 84 Kanosja	3	2	1	2	4	9	2	5	2	0
Totali	20	11	13	12	11	30	6	17	6	4

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në tabelë, rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 50% të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime Kunder Jetës të Kryera me Dashje” në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi një ulje prej 45,45 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 30,76 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 50% dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 63,63 % përkundrejt vitit 2014.

KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprën penale të cilat parashikohen në Kreun “Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi”:

KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI	2014					2015				
	Nr. Procd . Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënua r	Nr. Procd . Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënua r
Neni 85 Vrasja nga pakujdesia	0	0	0	0	0	1	1	1	1	0
Totali	0	0	0	0	0	1	1	1	1	0

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka rritje të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime kundër jetës të shkaktuar me

pakujdesi” 100 % në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014 nga 0 në 1 të tillë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë vepër penale, vihet re se numri i të pandehurve të regjistruar është rritur nga 0 në 1, numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit është rritur nga 0 në 1.

VEPRA PENALE KUNDER SHËNDETIT TE KRYERA ME DASHJE

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2015 është 3,65 %, ndërsa për vitin 2014 ky grup veprash përbënte 3,22 % të totalit të procedimeve. Pra, vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 88 Plagosje e rëndë	12	12	14	15	10	10	8	9	8	1
Neni 89 Plagosje e lehtë me dashje	68	32	82	52	20	77	43	102	59	48
Totali	80	44	96	67	30	87	51	111	67	49

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në tabele, rezulton se në vitin 2015 në Prokurorinë e rrethit Durrës ka një rritje prej 8,75 % e numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime Kundër Jetës të Kryera me Dashje” në krahasim me vitin 2014. Po kështu tendencë rritje prej 15,9 % paraqet edhe numri i procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 15,62 %, numër i njejtë i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 63,33 % përkundrejt vitit 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2015 është 3,65 %, ndërsa për vitin 2014 ky grup veprash përbënte 3,22 % të totalit të procedimeve. Pra, vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 88 Plagosje e rëndë	12	12	14	15	10	10	8	9	8	1
Neni 89 Plagosje e lehtë me dashje	68	32	82	52	20	77	43	102	59	48
Totali	80	44	96	67	30	87	51	111	67	49

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në tabelë, rezulton se në vitin 2015 në Prokurorinë e rrethit Durrës ka një rritje prej 8,75 % e numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime Kundër Jetës të Kryera me Dashje” në krahasim me vitin 2014. Po kështu tendencë rritje prej 15,9 % paraqet edhe numri i procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 15,62 %, numër i njëjtë i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 63,33 % përkundrejt vitit 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2015 është 0 % ndërsa për vitin 2014 ky grup veprash përbënte 0,04 % të totalit të procedimeve. Pra, vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 91 Plagosje e rëndë nga pakujdesia	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Neni 92 Plagosja e lehtë nga pakujdesia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka ulje të numrit 100 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime kundër shëndetit të shkaktuar me pakujdesi” në krahasim me vitin 2014.

Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re se numri i të pandehurve të regjistruar është ulur nga 1 në 2014 në 0 në vitin 2015, numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit është i njëjtë, pra 0 dhe gjithastu nuk ka pandehur të dënuar nga gjykata, pra numri është 0.

VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE MOSDHËNIA E NDIHMËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 0,2 %. Ky tregues për vitin 2014 ka qenë 0,16 %, pra vihet re një rritje e lehtë e tij për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

V. P. QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE NGA MOSDHËNIA E NDIHMËS	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 96 Mjekimi i pakujdesshëm	2	0	0	0	0	3	0	0	0	0
Neni 97 Mosdhënia e ndihmës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 98 Mosdhënia ndihmës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 99 Shkaktimi i vetëvrasjes	2	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Totali	4	0	0	0	0	5	0	0	0	0

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 25 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose nga mosdhënia e ndihmës, në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq numri i procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014 është i njëjtë pra 0. E njëjta gjë vërehet edhe në lidhje me numrin e të pandehurve të regjistruar, numrin e të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit dhe numrin e të pandehurve të dënuar nga gjykata përkundrejt të njëjtëve tregues të vitit 2014.

KRIME SEKSUALE

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2015 është 0,46 %, ndërkohë që për vitin 2014 ka qenë 0,12 %. Pra vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

KRIME SEKSUALE	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd. për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd. për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 100 M. Sek/ homoseksuale me të mitur	0	0	0	0	0	2	1	2	1	0
Neni 101 M. Sek/ homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0
Neni 102 M. Seksuale me dhunë me të rritura	0	0	0	0	0	3	0	2	0	0
Neni 104 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 108 Vepra të turpshme	2	2	2	2	1	5	2	4	2	0
Totali	3	2	2	2	1	11	3	9	3	0

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 266,66 % të numrit të procedimeve të regjistruara për krime seksuale në krahasim me vitin 2014. Po kështu kemi rritje prej 50 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 350 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 80 % dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 100 % përkundrejt vitit 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT

Pesha specifike që zë kjo vepër penale për vitin 2015 është 0,12% dhe për vitin 2014 ka qenë 0,12 %. Pra vihen re tregues të njëjtë për vitin 2015 dhe vitin 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 110 Heqja e paligjshme e lirisë	3	2	3	2	2	3	2	2	2	0
Totali	3	2	3	2	2	3	2	2	2	0

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 kemi të njëjtin numër të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër lirisë së personit” në krahasim me vitin 2014. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me procedimet e dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 33,33 %, numër i njëjtë i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata përkundrejt vitit 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 0,46 % ndërsa për vitin 2014 ka qenë 0,36 %. Pra, vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 113 Prostitucioni	3	2	7	7	0	0	0	0	0	0
Neni 114 Shfytëzimi i prostitucionit	3	3	2	7	2	4	0	3	0	0
Neni 117 Pornografia	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 121 Ndërhyrje të padrejta në jetën private	0	0	0	0	0	1	1	1	1	0
Neni 121/a Përndjekja	2	0	2	0	0	5	4	5	4	0
Neni 123 Pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0
Totali	9	5	11	14	2	11	5	10	5	0

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 22,22 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi të njëjtën shifër të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 9 %, po kështu ka ulje edhe numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit me 64,28 % dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 100 % përkundrejt vitit 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES

Gjatë vitit 2015 konstatohet angazhim specifik i Prokurorisë së rrethit Durrës lidhur me evidentimin, hetimin dhe dënimin e “veprave penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”. Gjithashtu, konstatohet rritje e ndjeshme e rasteve të referuara lidhur me këto vepra. Në vlerësimin e organit të Prokurorisë, kjo rritje është rrjedhojë e forcimit të besimit të publikut tek institucioni. Nga hetimet e pjesës më të madhe të rasteve, rezulton se viktimat kanë qenë në ushtrimin e dhunës për një kohë të gjatë dhe janë ndërgjegjësuar për raportimin e këtyre rasteve pranë organeve shtetërore. Gjithashtu, vlerësojmë se një rol pozitiv në shtimin e kallzimeve për këtë vepër penale ka dhënë edhe media. Seria e gjatë e emisoneve dhe kronikave sensibilizuese lidhur me këtë temë ka ndikuar në bindjen e qytetarëve, viktimave të dhunës, të kërkojnë mbrojtjen e institucioneve shtetërore.

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 3,69 %, ndërsa për vitin 2014 ka qenë 2,94 %. Pra, vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 124 Braktisja e fëmijëve të mitur	2	2	2	2	1	3	0	1	0	0
Neni 124/b Keqtrajtimi i të miturit	2	1	3	2	2	1	0	2	0	0
Neni 130 Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë	1	0	0	0	0	1	0	1	0	0

Neni 130/a Dhuna në familje	68	52	71	53	73	83	67	81	67	19
Totali	73	55	76	57	76	88	67	85	67	19

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 20,54 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 21,81 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 11,84 %, numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit është rritur me 17,54 % dhe ka ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 75 % përkundrejt vitit 2014. Një vend të veçantë në grupin e Veprave penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes zë dhuna në familje”. Vihet re se në vitin 2015 janë rregjistruar 83 procedime penale për veprën penale të parshikuar nga neni 130/a i Kodit Penal “Dhuna në Familje”, ndërkohë që në vitin 2014 ky numër ka qenë 68. Janë dërguar në gjykim 67 procedime penale nga ana e organit të prokurorisë në vitin 2015, në vitin 2014 ky tregues ka qenë 52, janë rregjistruar 81 të pandehur dhe është ngritur akuzë në gjykatë për 67 të pandehur, ndërkohë që në vitin 2014 janë regjistruar 71 të pandehur dhe është ngritur akuzë për 53 të tillë, janë dënuar nga gjykata 73 të pandehur për vitin 2014, ndërsa në vitin 2015 janë dënuar 19 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal “Dhuna në Familje”. Vepra penale e parashikuar nga neni 124/b paragrafi i dytë i Kodit Penal, detyrimi i të miturve për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij, mbetet ende një problem shqetësues.

LIRIA E BESIMIT

Për këtë grup veprash penale të dhënat statistikore tregojnë se gjatë vitit 2015 janë regjistruar procedime vetëm për veprën penale shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit. Rezulton se është regjistruar 1 procedim për këtë vepër, është pushuar akuza për të pandehurin dhe është dërguar për masë mjekësore.

VEPRA PENALE KUNDËR LIRSË SË BESIMIT	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 132 Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0
Totali	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0

DREJTIMI I AUTOMJETEVE NË GJENDJE TË DEHUR APO PA DËSHMI

Pesha specifike që kjo vepër penale zë për vitin 2015 është 10,76 %, ndërsa për vitin 2014 ka qenë 10,81 %. Pra, vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Gjatë vitit 2015 konstatohet në regjistrimin e procedimeve penale për veprën e parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal “Drejtimi i automjetit në gjendje të dehur apo pa dëshmi”. Krahasuar me vitin 2014, në vitin 2015, janë regjistruar 6,34 % procedime më pak.

DREJTIMI I AUTOMJETEVE NË GJENDJE TË DEHUR APO PA DËSHMI	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 291 Drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur apo pa dëshmi	268	265	273	271	360	251	251	256	253	199
Totali	268	265	273	271	360	251	251	256	253	199

VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE VJEDHJA E PASURISË

Nga të dhënat statistikore, rezulton se numri më i madh i procedimeve penale për vitin 2015 vijon të mbetet grupi i veprave penale “vjedhja e pasurisë”.

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 37,67 %, ndërsa në vitin 2014 ka qenë 41,88 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014. Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një ulje prej 12,48 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vjedhjen e pasurisë në krahasim me vitin 2014. Po ashtu, ka ulje të procedimeve penale për “vjedhje me dhune” prej 6,66 % krahasuar me vitin 2014. Ndërkohë, është shënuar rritje në procedimet penale për “vjedhje me armë”, e cila shënon 50 % më shumë se një vit më parë dhe “vjedhja me pasojë vdekjen”, e cila ka ulje prej 100 % krahasuar me vitin 2014.

VJEDHJA E PASURISË	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 134 Vjedhja	878	197	170	218	214	803	191	173	192	64
Neni 135 Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën	6	7	4	7	2	7	4	1	3	2

Neni 136 Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit	0	0	0	0	0	3	2	3	3	3
Neni 137 Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike	106	65	86	65	48	53	63	50	65	37
Neni 138 Vjedhja e veprave të artit e kulturës	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 139 Vjedhja me dhunë	30	11	18	15	23	28	18	14	22	4
Neni 140 Vjedhja me armë	2	0	0	0	0	3	0	1	0	0
Neni 141 Vjedhja me pasojë vdekjen	1	0	3	0	0	0	0	0	0	0
Neni 142 Sigurimi i mjeteve për vjedhje	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	1025	280	281	305	287	897	278	242	285	110

Sikurse vihet re, nga të dhënat statistikore rezulton së në vitin 2015 ka një ulje prej 12,48 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vjedhjen e pasurisë në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi ulje prej 0,71 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 13,87 %, një ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 6,55 % dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 61,67 % përkundrejt vitit 2014.

MASHTRIMET

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 1,93 %, ndërsa në vitin 2014 është 2,82 %. Pra, vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

MASHTRIMET	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 143 Mashtrimi	52	21	17	10	2	31	28	21	23	3
Neni 145 Mashtrimi në sigurime	17	11	13	11	10	7	5	4	5	4
Neni 146 Mashtrimi në kredi	1	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 149/a Shkelja e të drejtave të pronësisë industrial	0	0	0	0	0	6	0	1	0	0
Totali	70	32	30	21	12	46	33	26	28	7

Shihet një ulje prej 34,28 % e numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të mashtrimit të vitit 2015 në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 3,12 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 13,33 %, një rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 33,33 % dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 41,66 % përkundrejt vitit 2014.

SHKATËRRIMI I PRONËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 2,56 %, ndërsa për vitin 2014 ka qenë 2,7 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

SHKATËRRIMI I PRONËS	2014					2015				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 150 Shkatërrimi i pronës	10	2	4	3	3	24	12	11	14	1
Neni 151 Shkatërrimi i pronës me zjarr	19	3	5	3	3	25	6	6	6	0
Neni 152 Shkatërrimi i pronës me eksploziv	5	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 155 Shkatërrimi i rrugëve	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 156 Shkatërrimi i rrjetit elektrik	2	0	0	0	0	4	1	1	1	0
Neni 159 Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit	30	19	20	19	7	3	8	1	8	7
Neni 161 Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 162 Përplasja e mjeteve të transportit masiv	0	0	0	0	0	3	3	4	4	0
Totali	67	24	29	25	13	61	30	23	33	8

Sikurse vihet re, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka ulje në krahasim me vitin 2014, në masën 8,95 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të shkatërrimit të pronës. Ndërkaq kemi rritje prej 25 % të procedimeve të

dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 20,68 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 32 % dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 38,46 % përkundrejt vitit 2014.

NDËRTIMI I PALIGJSHËM

Pesha specifike qe ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 4,95 %, për vitin 2014 ka qenë 4,92 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Ndër veprat penale që kanë pasur rritje më të madhe të procedimeve gjatë vitit 2015 vlerësohet “Ndërtimi i paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a të Kodit Penal. Referuar statistikave, në vitin 2015 konstatohet ulje në shifren 3,27 %, krahasuar me vitin 2014.

VEPRA PENALE QË CENOJNË RREGJIMIN JURIDIK TË TOKËS	2014					2015				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 199 Shpërdorimi i tokës	2	0	2	0	0	2	0	0	0	0
Neni 199/a Ndërtimi i paligjshëm	118	46	55	44	13	114	157	111	160	53
Neni 200 Pushtimi i tokës	2	0	1	1	1	2	1	1	1	1
Totali	122	46	58	45	14	118	158	112	161	54

VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 0,09 %, për vitin 2014 ka qenë 0 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 164/b Korrupsioni pasiv në sektorin privat	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0

Neni 170/a Punësimi i paligjshëm	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0
Totali	0	0	0	0	0	2	0	2	0	0

Sikurse vihet re nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka rritje të dy treguesve të lidhur me procedimin penal. Kështu, në vitin 2014 janë regjistruar 0 procedime penale për këtë grup veprash penale, ndërkohë në vitin 2015 janë regjistruar 2 procedime penale, ose 100 % më shumë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re rritje me 100 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt vitit 2014.

VEPRA PENALE NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE BANKARE DHE FINANCIARE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 0,37 %, ndërsa për vitin 2014 është 0,52 %, për vitin 2014. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

V. P. NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE BANKARE DHE FINANCIARE	2014					2015				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 170/ç Ushtrimi pa licencë i veprimtarive financiare	13	7	10	7	6	9	8	9	8	5
Totali	13	7	10	7	6	9	8	9	8	5

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një ulje prej 30,76 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare, në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 14,28% të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 10 %, një rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 14,28 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 16,66 % përkundrejt vitit 2014.

KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 1,46 %, ndërsa për vitin 2014 është 2,05%. Pra, vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 172 Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë	33	6	12	15	2	15	0	10	0	0
Neni 174 Kontrabanda me mallra të tjera	12	6	1	6	7	14	0	3	0	0
Neni 177 Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 178 Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë	4	5	7	8	1	2	0	1	0	0
Neni 179/a Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë	2	2	2	2	2	3	3	3	3	0
Totali	51	19	22	31	12	35	3	17	3	0

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një ulje prej 31,37 % të numrit të procedimeve të regjistruara për krime në fushën e doganave në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi ulje prej 84,21 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 22,72 %, një ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 90,3 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 100 % përkundrejt vitit 2014.

VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT DHE TATIMET

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 1,67 %, ndërsa për vitin 2014 është 0,6 %. Pra vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT DHE TATIMET	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 180 Fshehja e të ardhurave	14	1	9	1	1	9	0	3	0	0
Neni 181 Mospagimi i taksave dhe tatimeve	1	2	1	2	1	31	7	10	7	0
Totali	15	3	10	3	2	40	7	13	7	0

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 166,66 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 133,33 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re sërish rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 30 %, rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 133,33 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 100 % përkundrejt vitit 2014.

FALSIFIKIMI I MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 0,29 %, ndërsa për vitin 2014 është 0,4 %. Pra, vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

FALSIFIKIMI I MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 183 Falsifikimi i monedhave	10	1	3	1	1	7	5	5	5	1
Totali	10	1	3	1	1	7	5	5	5	1

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një ulje prej 40 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Falsifikimi i monedhave dhe i letrave me vlerë” në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 66,66 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët

i janë dërguar gjyqit prej 400% dhe numër i njëjtë i të pandehurve të dënuar nga gjykata me vitin 2014.

FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 3,44 %, ndërsa për vitin 2014 është 3,02 %. Pra, vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 186 Falsifikimi i dokumenteve	31	14	8	20	16	43	12	7	18	1
Neni 187 Falsifikimi i dokumenteve shkollore	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0
Neni 189 Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave	31	25	28	26	24	22	20	14	23	8
Neni 190 Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve	12	6	7	6	5	16	8	2	10	1
Neni 191 Falsifikimi i akteve të gjendjes civile	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	75	45	43	52	45	82	40	24	51	10

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 9,33 % të numrit të procedimeve të regjistruara për grup veprat e falsifikimit të dokumenteve në krahasim me vitin 2014. Numri i procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014 ka një ulje me 11,11 %. Në lidhje me të pandehurit, vërehet sërish ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 44,18 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 1,92 % dhe sërish ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 77,77 % përkundrejt vitit 2014.

ZHVILLIMI I PALEJUAR I LOJËRAVE TË FATIT

Rritja e konsideruar e procedimeve penale gjatë vitit 2015 konstatohet për veprat penale, parashikuar nga neni 197 dhe 198 te Kodit Penal, në seksionin “Zhvillimi i palejuar i lojrave të fatit”.

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 0,83 %, ndërsa për vitin 2014 është 0,1 %. Pra vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

ZHVILLIMI I PALEJUAR I LOJËRAVE TË FATIT	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 197 Organizimi i llotarive të palejuara	27	29	21	29	15	20	26	15	25	9
Totali	27	29	21	29	15	20	26	15	25	9

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një ulje prej 25,92 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit, në krahasim me vitin 2014. Ndërsa numri i procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014 ka pësuar ulje me 10,34 %. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 21,57 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit me 14,79%. Ulje ka numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata me 40 % përkundrejt vitit 2014.

VEPRA PENALE QË CËNOJNË REGJIMIN JURIDIK TË TOKËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 4,95 %, ndërsa për vitin 2014 ky tregues ka qenë 4,92 %. Pra vihet re një rritje e lehtë treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

VEPRA PENALE QË CËNOJNË RREGJIMIN JURIDIK TË TOKËS	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 199 Shpërdorimi i tokës	2	0	2	0	0	2	0	0	0	0
Neni 199/a Ndërtimi i paligjshëm	118	46	55	44	13	114	157	111	160	53
Neni 200 Pushtimi i tokës	2	0	1	1	1	2	1	1	1	1
Totali	122	46	58	45	14	118	158	112	161	54

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një ulje prej 3,27 % të numrit të procedimeve të regjistruara për Vepra penale që çenojnë regjimin juridik të tokës, në krahasim me vitin 2014 dhe rritje prej 243,47 % të procedimeve të dërguara për gjykim. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re rritje prej 93,1 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 257,77 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 285,71 % përkundrejt vitit 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 0,37 % , ndërkohë që për vitin 2014 është 0,2 %. Pra vihet re rritje e peshës specifike të këtij grupi veprash penale për vitin 2015.

VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 203 Ndotja e ujërave	0	0	0	0	0	3	1	1	1	0
Neni 205 Prerja e paligjshme e pyjeve	4	0	2	0	0	6	0	5	0	0
Neni 206 Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	5	0	2	0	0	9	1	6	1	0

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 80 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra Penale Kundër Mjedisit” në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 100 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 200 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 100 % dhe nuk kemi të pandehur të dënuar nga gjykata siç ka ndodhur dhe në vitin 2014.

KRIME KUNDËR AUTORITETIT TË SHËTETIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 2 %, ndërsa për vitin 2014 ka qenë 1,25 %. Pra vihet re një rritje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

KRIME KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 235 Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik	2	0	2	0	0	2	2	2	2	0
Neni 236 Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit public	14	10	18	11	0	15	14	19	22	5
Neni 237 Goditjet për shkak të detyrës	5	4	6	5	0	8	8	9	9	4
Neni 238 Kanosja për shkak të detyrës	2	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 242 Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik	7	5	8	6	0	17	15	23	20	0
Neni 244	0	0	0	0	0	2	2	2	2	1
Neni 245/1/2	0	0	0	0	0	3	2	2	6	0
Neni 247 Mbajtja pa të drejtë e uniformës	1		0	0	0	1	0	1	0	0
Totali	31	19	34	22	0	49	43	58	61	10

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 58,06 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krimet kundër autoritetit të shtetit” në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 126,31 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 70,58 %, një rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 177,27 % dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 100 % përkundrejt vitit 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK

Pesha specifike qe ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 1,76 %, ndërsa në vitin 2014 pesha e kësaj vepre ka qenë 2,13 %. Pra, vihet re ulje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 248 Shpërdorimi i detyrës	35	4	3	10	2	31	7	9	12	2
Neni 70 KPU	4	1	3	3	0	2	0	1	0	0
Neni 250 Kryerja e veprimeve arbitrare	2	0	0	0	0	4	1	7	3	0
Neni 257/a Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurisë	7	1	7	1	0	3	1	3	1	1
Neni 259	5	2	3	4	0	2	0	0	0	0
Totali	53	8	16	18	2	42	9	20	16	3

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një ulje prej 16,98 % të numrit të procedimeve të regjistruara për Vepra Penale Kundër Veprimtarisë Shtetërore të Kryera nga Punonjësit Shtetërorë ose në Shërbim Publik”, në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 12,5 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 25 %, një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 11,11 % dhe rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 50 % përkundrejt vitit 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 24,44 %, ndërsa në vitin 2014 ka qenë 22,72 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar

Neni 261 Pengimi në ushtrimin e të drejtës për t'u shprehur, grumbulluar apo manifestuar	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 262 Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 267 Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik	0	0	0	0	0	7	1	2	2	0
Neni 270 Rebelimi i të burgosurve	0	0	0	0	0	2	2	2	2	2
Neni 273 Largimi nga vendi i aksidentit	30	9	12	9	6	27	8	9	9	2
Neni 274 Prishja e qetësisë publike	1	0	1	0	0	6	2	11	8	0
Neni 275 Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike	54	6	10	6	5	55	10	18	10	2
Neni 277 Vetëgjyqësia	6	3	3	3	1	10	8	10	10	2
Neni 278 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit	56	39	39	42	45	44	33	36	34	11
Neni 279 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta	11	11	12	12	16	6	5	7	6	7
Neni 280 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive	10	7	10	9	9	2	2	2	2	0
Neni 283 Prodhimi dhe përdorimi i lendeve narkotike	74	50	86	54	50	83	40	95	54	12
Neni 284	4	0	3	0	0	10	4	6	5	1
Neni 286 Nxitja për përdorimin e drogës	2	0	3	0	0	0	0	0	0	0
Neni 288 Prodhimi dhe shitja e ushqimeve dhe e lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0

Neni 288/a Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrialë dhe ushqimorë	1	0	1	0	0	1	0	1	0	0
Neni 289 Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë	4	0	1	0	0	11	0	4	0	0
Neni 290 Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	41	33	40	33	32	63	42	59	42	13
Neni 291 Drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur apo pa dëshmi	268	265	273	271	360	251	251	256	253	199
Neni 293 Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit	1	0	0	0	0	1	0	5	0	0
Totali	563	423	494	439	524	582	408	523	437	251

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 3,37 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi ulje prej 3,54 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 5,87 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 0,49 % dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 52,09 % përkundrejt vitit 2014.

VEPRA PENALE QË LIDHEN ME PASTRIMIN E PARAVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 1,04 %, ndërsa në vitin 2014 ky tregues ka qenë 0,64 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

PASTRIMI I PARAVE	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 287 Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale	15	1	2	1	0	24	0	0	0	0

Neni 287/b Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale	1	1	5	5	3	1	1	4	5	0
Totali	16	2	7	6	3	25	1	4	5	0

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 56,25 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale, në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi ulje prej 50 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Edhe në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e treguesve në krahasim me vitin 2014, kështu numri të pandehurve të regjistruar është ulur 42,85 %, numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit është ulur 16,66 % dhe numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata me 100 % përkundrejt vitit 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR SEKRETIT DHE KUFIJVE SHETETËRORË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 1 %, ndersa ne vitin 2014 ka qenë 1,29 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR SEKRETIT DHE KUFIJVE SHETETËRORË	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 295/a Zbulimi i akteve ose të dhënave secrete	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 297 Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror	20	7	24	10	7	20	11	23	13	5
Neni 298 Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve	11	7	11	8	10	3	0	6	0	0
Totali	32	14	35	18	17	24	11	29	13	5

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një ulje prej 25 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë, në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi ulje prej 21,42 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të

pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 17,14 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 27,77 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 70,58 % përkundrejt vitit 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015, është 1,38 % ndërsa për vitin 2014 ka qenë 1,17 %. Pra vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 300 Moskallëzimi i krimit	0	0	0	0	0	1	2	14	21	5
Neni 305 Kallëzimi i rremë	3	3	3	3	1	5	7	6	8	0
Neni 305/b Deklaratat e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore	0	0	0	0	0	1	2	2	5	0
Neni 306 Dëshmia e rreme	5	0	5	0	0	2	2	2	2	0
Neni 309 Ekspertimi i rremë	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 311 Kanosja për të mos kallëzuar	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 313/a Zhdukja ose humbja e fashikullit	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 320 Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës	3	0	0	0	0	7	6	6	6	0
Neni 321 Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës	15	9	13	8	5	15	17	13	15	6
Neni 322 Prishja e vulave dhe shenjave	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 323 Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit	1	1	1	1	1	0	0	0	0	0
Totali	29	13	22	12	7	33	36	43	57	11

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 13,79 % të numrit të procedimeve të regjistruara për Vepra penale kundër drejtësisë në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 176,92 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 95,45 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 375 %. Numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është rritur me 57.14 % krahasuar me vitin 2014.

VEPRA PENALE QË PREKIN ZGJEDHJET E LIRA DHE SISTEMIN DEMOKRATIK TË ZGJEDHJEVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015, është 0.04 % ndërsa për vitin 2014 ka qenë 0 %. Pra ky tregues ruan pothuajse të njëjtën vlerë për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

VEPRA PENALE QË PREKIN ZGJEDHJET E LIRA DHE SISTEMIN DEMOKRATIK TË ZGJEDHJEVE	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 329 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Totali	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 si vit zgjedhor është regjistruar 1 procedim penal për “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”.

VEPRAT PENALE KUNDËR KORRUPSIONIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 0,37 %, ndërsa për vitin 2014 ka qenë 0,27 %. Pra, ky tregues ka një rritje të lehtë për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR KORRUPSIONIT	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 164/b Korrupsioni pasiv në sektorin privatit	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0
Neni 244 Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	0	0	0	0	0	2	2	2	2	1
Neni 245/1 Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike	0	0	0	0	0	3	2	2	6	1
Neni 259 Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike	5	2	3	4	0	2	0	0	0	0
Neni 319/ç Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Totali	6	2	3	4	0	9	4	5	8	2

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 50 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të korrupsionit, në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi 100 % procedime më shumë të dërguara për gjykim në vitin 2015 sesa në vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 66,66 %, një rritje të numrit të të pandehurve të cilet i janë dërguar gjyqit prej 100 % dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 100 % përkundrejt vitit 2014.

KRIMI KIBERNETIK

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 0,33 % ndërsa për vitin 2014 ky grup veprash përbënte 0,12 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

KRIMI KIBERNETIK	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 143/b Mashtimi kompjuterik	1	0	1	0	0	3	0	0	0	0
Neni 186/a Falsifikimi kompjuterik	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 192/b Hyrja e paautorizuar kompjuterike	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 293/b Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike	0	0	0	0	0	3	0	1	0	0
Neni 293/c Ndërhyrja në sistemet kompjuterike	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	3	0	1	0	0	8	0	1	0	0

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 166,66 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër krimit kompjuterik në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq nuk kemi procedime penale të dërguara për gjykim në vitin 2015 ashtu si dhe në vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re i njëjti numër i të pandehurve të regjistruar në vitin 2015 dhe në vitin 2014 , nuk kemi të pandehur të cilët i janë dërguar në gjyq dhe të pandehur të dënuar nga gjykata në vitin 2015 dhe në vitin 2014.

TRAFIQET E PALIGJSHME

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 1 % ndërsa në vitin 2014 ka qenë 0,79 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

TRAFIKIMI	2014					2015				
	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd. Regj	Nr. Procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 128/b Trafikimi i të miturve	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0

Neni 141/a Trafikimi i mjeteve motorike	19	1	1	1	0		23	3	1	3	0
Totali	19	1	1	1	0		24	3	1	3	0

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 26,31 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të trafikeve te paligjshme në krahasim me vitin 2014. **Ndërkaq kemi rritje prej 200 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014.** Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, është regjistruar 1 i pandehur sa edhe në vitin 2014, kemi nje rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 200 % dhe nuk kemi të pandehur të dënuar.

VII. PËRMBUSHJA E ANGAZHIMEVE DHE DETYRAVE TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DURRES PËR VITIN 2016.

Më lejoni t'ju bëj të ditur përmbushjen dhe angazhimin e prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës në kuadrin e zbatimit të prioritetëve, urdhërave e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, me synim rritjen e efektivitetit të ndjekjes penale, duke garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Duke fuqizuar dhe përmiresuar më tej ndjekjen penale në hetim dhe në gjykim si dhe mbikqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale, duke rritur transparencën në procesin penal si dhe duke bashkërenduar punën me policinë gjyqësore, pasi këto marrëdhënie janë shumë të rëndësishme për një luftë të suksesshme kundër kriminalitetit dhe e kundërta do të favorizonte e inkurajonte rritjen e kriminalitetit.

Garantojmë se do të jemi më aktivë në orientimin e oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe në kontrollin e punës së tyre gjatë fazës së hetimeve duke, garantuar dhe pjesëmarrjen e Prokurorit në vendngjarje.

Për vitin 2016 objektivat tona do të jenë të fokusuara në rritjen dhe efektivitetin në ushtrimin e ndjekjes penale duke përmirësuar dhe rritur me tej cilësinë e hetimit ngritjen e akuzës dhe përfaqësimin e saj në gjykatë duke patur gjithmonë në fokusin e punës sonë garantimin dhe respektimin e interesave dhe lirive të shtetasve.

Do të fokusohemi në rritjen e transparencës dhe besimit të publikut tek veprimtaria e punës sonë, po ashtu në vëmendjen e punës tonë të përditshme do të kemi parasysh dhe do të zbatojmë të gjitha prioritetet dhe objektivat e hartuara nga Prokurori i Përgjithshëm që kanë të bëjnë me forcimin e hetimit të kriminalitetit dhe paligjshmërisë.

Sa më sipër, Ju bëra të ditur treguesit me kryesorë të ndjekjes penale të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, ngritjes së akuzës në gjykatë dhe të ekzekutimit të vendimeve penale. Ju siguroj se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe trupa e prokurorëve do të realizojnë prioritetet në luftën kundër kriminalitetit duke rritur më tej efektivitetin në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit, si dhe duke garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Ju faleminderit!

DREJTUESI I PROKURORISË

Agron GJANA